



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9943 Prot.

Roskovec, më 24.12.2024

VENDIM

NR. 75, DATË 23.12.2024

PËR

BASHKIMIN E NDËRMARRJEVE VARTËSE TË BASHKISË ROSKOVEC NË NJË NJËSI SHPENZUESE ME EMËRTIM “NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE” BASHKIA ROSKOVEC

Në mbështetje të nenit 1 pika 7, nenit 3, nenit 4, nenit 9 pika 1.1 gërma “c” dhe pika 1.6 gërma “b”, nenit 13. neneve 21-23, nenit 27, nenit 29, neneve 32-33, neneve 40-41, si dhe nenit 54 shkronja “d” dhe “k” të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar; Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Bashkimin e “Ndërmarrjes së Pyjeve, Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rruge e Varreza” dhe “Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Mjedisit” me “Ndërmarrjen e Shërbimeve Komunale” me emërtim “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” e Bashkisë Roskovec.
2. Transferimin e punonjësve sipas funksionit të deleguar vetëm për sektorin e arsimit parashkollor nga Qendra Ekonomike Arsimore në strukturën e Bashkisë Roskovec, si dhe transferimin e punonjësve mbështetës (roje dhe sanitare) në ndërmarrjen e re “Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”.

3. Mbylljen e tre njësive shpenzuese “Qendrës Ekonomike Arsimore”, “Ndërmarrjes së Pyjeve, Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rruge e Varreza”, “Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Mjedisit”, duke pushuar së funksionuari si njësi buxhetore më vete.
4. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të funksionojë me numër unik NIPT-i, konkretisht me NIPT-in që ka aktualisht Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale L92507531J.
5. Organizimi dhe funksionimi i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike do të bëhet sipas strukturës që do të miratohet nga Kryetari i Bashkisë Roskovec, në bazë të kompetencave që i jep ligji, duke mos tejkaluar numrin e përgjithshëm që do të miratohet me Vendim të Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2025.
6. Procesi i transferimit të fondeve buxhetore, aktiveve afatgjatë dhe afatshkurtër, burimeve njerëzore dhe funksioneve financiare si rezultat i procesit të sipërpërmendur, të kryhet në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi.
7. Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Roskovec të bëjë bashkimin e fondeve të mbetura pasi të jenë paguar pagat dhe detyrimet tatimore të muajit Janar 2025, sipas llogarive ekonomike që do të miratohen nga Këshilli i Bashkisë me vendimin për miratimin e buxhetit të vitit 2025.
8. Ngarkohen personat përgjegjës të Ndërmarrjeve vartëse aktuale për të mbyllur të gjitha veprimet financiare sipas ligjit në fuqi.
9. Për ndjekjen e procedurave të nevojshme në institucionet shtetërore për funksionimin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, ngarkohet ekzekutivi i bashkisë Roskovec.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka

